

Begaj në OKB:
Anëtarësimi i Kosovës
është akt drejtësie



FAQE 5

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FAMILJET NË KOSOVË, NËN PRESIONIN E INFLACIONIT

FAQE 4-5



Familjet në Kosovë po përballen me rritje të lartë të çmimeve, duke shpenzuar më shumë, por duke blerë më pak. Pensionistët dhe familjet me të ardhura të ulëta janë më të

prekur nga rritja e çmimeve - shpesh të detyruar të heqin dorë nga produktet e caktuara ose t'i shtyjnë pagesat e domosdoshme. Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK)

tregojnë se inflacioni, që reflekton rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, është rritur për 4.5 % në gusht krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar

**ROHDE: KOSOVA
DUHET TË TREGOJË
SERIOZITET PËR
DETYRIMET NË DIALOG,
TA NISË ZBATIMIN E
ASOCIACIONIT** F. 5



**OSMANI BISEDON
ME KALLASIN
PËR ZHVILLIMET
E FUNDIT DHE
KËRKON HEQJEN
E MASAVE NDAJ
KOSOVËS** F. 3



**AKB-ja: 9 MILIARDË EURO
TË DIASPORËS JANË FUTUR NË
BANESA, KAPITAL I VDEKUR PËR
EKONOMINË E KOSOVËS** F. 8

**KRYETARI I OEK-ut PARAQITI
PLATFORMËN DIGJITALE AGRO B2B** F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

SPORT

**BASHKIMI DEBUTON ME FITORE TË
MADHE NË FIBA EUROPE CUP** F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

VANCE DHE RUBIO I BËJNË JEHONË QASJES SË RE DHE TË ASHPËR TË TRUMPIT KUNDËR LUFTËS SË RUSISË

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Nënpresidenti amerikan JD Vance dhe sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i kanë bërë jehonë qasjes së re, më të ashpër, të presidentit Donald Trump kundër Rusisë, duke e akuzuar Moskën se nuk po bën mjaftueshëm për t'i dhënë fund luftës dhe për t'i ndaluar vrasjet në Ukrainë.

Të mërkurën mbrëma Vance tha se Trumpi "mendon se ata nuk po bëjnë mjaftueshëm në tavolinën e bisedimeve për t'i dhënë fund luftës... Nëse rusët nuk pranojnë të bisedojnë me mirëbesim, mendoj se do të jetë shumë, shumë keq për vendin e tyre".

Ndërkohë, Rubio u takua me ministrin e Jashtëm të Rusisë, Sergei Lavrov, në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ku përsëriti thirrjen e Trumpit "për t'u dhënë fund vrasjeve dhe nevojën që Moska të ndërmarrë hapa domethënës drejt një zgjidhjeje të qëndrueshme të luftës Rusi - Ukrainë".

Lavrovi u përgjigj duke thënë se ka "interes të përbashkët për të gjetur zgjidhje paqësore" për luftën në Ukrainë. Por, ai përsëriti nevojën e Moskës për t'i "eliminuar shkaqet rrënjësore të

konfliktit ukrainas". Kjo është gjuha e Kremlinit për të vendosur kufizime mbi fuqinë ushtarake të Ukrainës dhe një zotim që ajo të mos i bashkohet NATO-s. Këto janë vetëm disa nga kërkesat e shumta historike të Moskës, shumica e të cilave janë të papranueshme për Kievin dhe Perëndimin.

Ndërkohë, në Moskë, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, e hodhi poshtë pretendimin se Ukraina mund ta rimarrë të gjithë tokën e saj të pushtuar, duke thënë se "ideja se Ukraina mund të rikthejë diçka është, sipas pikëpamjes sonë, e gabuar".

Qëndrimi i ri i administratës amerikane vjen pasi Trumpi, duke bërë kthesë të papritur, tha më 23 shtator në rrjetet sociale se Ukraina mund ta rimarrë të gjithë tokën e pushtuar nga Rusia me ndihmën e mbështetësve të saj evropianë. Rusia kontrollon rreth një të pestën e tokës së Ukrainës, përfshirë gadishullin e Detit të Zi, Krimenë, e cila u aneksua në mënyrë të paligjshme në vitin 2014.

Në të kaluarën Trumpi dhe zyrtarë të tjerë amerikanë kanë lënë të kuptohet se Ukraina do të duhet t'i japë pjesë të tokës së



vet Rusisë në marrëveshje për paqe.

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, dhe vendi i tij "janë në telashe të mëdha ekonomike", shkroi Trumpi në platformën "Truth Social". "Pasi e kam kuptuar plotësisht gjendjen ushtarake dhe ekonomike të Ukrainës dhe Rusisë, dhe pasi pashë problemet ekonomike që ajo po i shkakton Rusisë, mendoj se Ukraina, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, është në gjendje të luftojë dhe ta rimarrë të gjithë tokën e saj në formën e saj origjinale", shkroi Trumpi.

Në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme disa orë më vonë, Trumpi tha se Shtetet e Bashkuara janë "plotësisht të përgatitura për të vendosur një raund shumë të fortë tarifash të fuqishme", nëse Rusia nuk është "gati të bëjë një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës".

Por, ai përsëriti kushtin e tij të fundit që Evropa të ndërmarrë veprime të ngjashme, duke thënë se, "që këto tarifa të jenë efektive, vendet evropiane... duhet të na bashkohen duke miratuar masat të njëjta".

Këto deklarata nënkuptojnë se

presidenti amerikan ka ndryshuar bindshëm qasjen e tij.

Sepse Trumpi gjatë në vitet e fundit e ka lavdëruar shpesh Putinin dhe e ka fajësuar Ukrainën për konfliktin, i cili u shndërrua në luftë të hapur pasi Rusia e nisi pushtimin e fqinjit në shkurt të vitit 2022.

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha se ishte i befasuar nga deklaratat e fundit të Trumpit, por i quajti ato shenjë pozitive se Uashingtoni do ta mbështesë Kievin deri në fund të luftës.

SARKOZY DËNOHET ME PESË VJET BURGIM

Paris, 25 shtator - Një gjykatë në Paris e dënoi ish-presidentin francez Nicolas Sarkozy me pesë vjet burgim, pasi e gjeti fajtor për komplot lidhur me një skemë të supozuar për financimin e fushatës së tij presidenciale më 2007 me fonde nga Libia.

Gjykata vendosi se ai do të burgoset edhe nëse e apelon vendimin. Por, gjykata tha se data për dërgimin e tij në burg do të caktohet më vonë.

Gjykata e gjeti fajtor Sarkozyn për pjesëmarrje në organizatë kriminale në komplotin nga viti 2005 deri më 2007 për financimin e fushatës së tij me fonde nga Libia në këmbim të favoreve diplomatike. Por, ai u lirua nga tri akuza të tjera, përfshirë për korrupsion pasiv, financim të paligjshëm të fushatës dhe fshehje të fondeve të përvetësuara publike.

Sarkozy, 70 vjeç, e kritikoi vendimin dhe tha se ai ishte viktimë e një padrejtësie skandaloze, duke shtuar se do ta apelojë vendimin. "Kjo padrejtësi është skandaloze. Kërkoj nga populli francez, pavarësisht nëse ka votuar për mua apo jo, të mendojë për këtë çfarë ndodhi.



Urrejtja vërtet nuk ka kufij", tha ai. Gjykata, po ashtu, gjeti fajtorë dy bashkëpunëtorët më të ngushtë të Sarkozys kur ai ishte president - ish-ministrit Claude Gueant Brice Hortefeux - për të njëjtën akuzë.

Edhe ata u liruan nga tri akuzat e tjera sikurse ish-presidenti francez.

Sipas vendimit, Gjykata beson se të pandehurit kishin bërë komplot për të kërkuar fonde nga Libia për fushatën e Sarkozys më 2007, por gjykatësit nuk u bindën se vetë ish-presidenti ishte drejtpërdrejt i

përfshirë në përpjekjet për financim ose nëse ndonjë fond nga Libia u përdor për fushatën e tij presidenciale.

Kryetarja e trupit gjykues tha se Sarkozy lejoi bashkëpunëtorët e tij që të kontaktonin me autoritetet në Libi "për të marrë apo për të tentuar që të merrnin mbështetje nga Libia me qëllim financimin e fushatës". Por, gjykata tha se nuk arriti të përcaktonte nëse para nga Libia ishin përdorur për financimin e fushatës së Sarkozys. Megjithatë, sipas ligjeve në

Francë, një skemë e tillë konsiderohet krim edhe nëse paratë nuk janë pranuar apo nuk mund të vërtetohet se janë pranuar, shpjegoi gjykata.

Sarkozy së bashku me bashkëshorten e tij, Carla Bruni-Sarkozy, ishin të pranishëm në gjykatore.

Sarkozy ishte zgjedhur president më 2007, por kishte humbur garën për rizgjedhje më 2012. Ai ka mohuar të gjitha akuzat gjatë gjykimit që u mbajt për tre muaj më herët gjatë këtij viti. Në këtë

rast kanë qenë të përfshirë edhe 11 persona të tjerë, përfshirë tre ish-ministra.

Akuzat u ngritën pasi më 2011 agjencia shtetërore e lajmeve në Libi dhe vetë diktatori i ndjerë, Muammar Gaddafi, kishin thënë se shteti i Libisë në mënyrë sekrete kishte dërguar miliona euro për fushatën presidenciale të Sarkozys.

Më 2012 një media në Francë publikoi një memo të inteligjencës libiane që fliste për një marrëveshje për financim prej 50 milionë eurosh. Sarkozy e kishte hedhur poshtë këtë dokument.

Hetuesit, po ashtu, kanë hetuar një sërë udhëtimesh në Libi që kishin realizuar njerëz të afërt të Sarkozys kur ai kishte qenë ministër i Brendshëm nga viti 2005 deri më 2007.

Prokurorët kanë pretenduar se Sarkozy me vetëdije kishte përfituar nga ajo që e përshkruan si "pakt korruptiv" me qeverinë e Gadafit.

Diktatori i Libisë u rrëzua nga pushteti dhe u vra gjatë kryengritjes më 2011, që i dha fund sundimit të tij prej katër dekadash në këtë shtet të Afrikës së Veriut.

KURTI UDHËTON PËR NË SHBA

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të marrë pjesë në javën e nivelit të lartë të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), njoftoi zyra e tij të enjten. Kurti do të zhvillojë "takime dypalëshe me liderë në kuadër të javës së nivelit të lartë të sesionit të 80 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara", thuhet në njoftim. Kryeministria nuk tregoi se kush janë liderët me të cilët do të mbajë takime dypalëshe Kurti. Ajo tha se "përmes pjesëmarrjes në javën e nivelit të lartë dhe takimeve të parapara synohet

thellimi i raporteve bilaterale me vende partnere, fuqizimi i mëtejshëm i subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit tonë në raport me vendet mosnjohëse dhe prezantimi i mundësive dhe përparësive që Kosova ofron për investitorë të huaj". Gjatë qëndrimit në Nju-Jork, Kurti do të takojë pjesëtarë të komunitetit shqiptar në ShBA dhe përfaqësues të shoqatave të diasporës, sipas njoftimit. Udhëtim i Kurtit në Nju-Jork vjen në një kohë kur marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara pësojnë një goditje në fillim të këtij muaji. Uashingtoni njoftoi më 12 shtator për pezullimin e dialogut të planifikuar strategjik për shkak të veprimeve të

Qeverisë në detyrë të Kosovës, që tha se kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë në vend. Ambasada e Amerikës në Prishtinë tha se veprimet e qeverisë së udhëhequr nga Kurti kanë "rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë, duke kufizuar aftësinë e Shteteve të Bashkuara për të punuar në mënyrë produktive me Kosovën mbi prioritetet e përbashkëta". "Fatkeqësisht, veprimet dhe deklaratat e fundit të kryeministrit në detyrë, Kurti, kanë paraqitur sfida për progresin e arritur ndër vite", tha ajo, pa shpjeguar se për çfarë deklaratash dhe veprimesh bëhet fjalë saktësisht. Kurti tha më vonë se qeveria në



detyrë ka "disa" dallime në qëndrime me ShBA-në, por nguli këmbë se raportet mes dy vendeve nuk janë prishur. Ai tha se dallimet mes tij dhe Shteteve të Bashkuara "shpesh kanë të bëjnë me qëndrimet

tona në raport me Serbinë dhe veprimet ndaj strukturave ilegale të saj në Kosovë". Ndërkohë, në Nju-Jork këtë javë ndodhet edhe presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e cila ka zhvilluar disa takime deri tani.

OSMANI BISEDON ME KALLASIN PËR ZHVILLIMET E FUNDIT DHE KËRKON HEQJEN E MASAVE NDAJ KOSOVËS

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, njoftoi të enjten se ka zhvilluar një bisedë me përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe në rajon. Osmani u takua me Kallasin në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara, ku tha se i kërkoi asaj që BE-ja t'i heqë masat ndëshkuese ndaj Kosovës. "Integrimi i Kosovës në BE mbetet ndër prioritetet tona kryesore shtetërore. Në këtë frymë, ritheksova domosdoshmërinë e heqjes së masave të padrejta të BE-së ndaj Kosovës, të cilat po i dëmtojnë të gjithë qytetarët tanë, pa përjashtim", tha Osmani. BE-ja vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës më 2023 - pas rritjes së tensioneve në veri të vendit - dhe e kishte arsyetuar mbajtjen e tyre në fuqi duke thënë se Kosova nuk po bënte mjaftueshëm për shtensionimin e gjendjes në veriun e banuar me shumicë serbe. Kallas tha në maj, në vizitën e saj të parë në Kosovë, si shefe e diplomacisë së bllokut evropian, se kishte filluar



heqja graduale e masave. Ajo nuk kishte shpjeguar asokohe se çfarë masash mund të jenë hequr, por "Radio Evropa e Lirë" mësoi nga burime të saj në Bruksel masat që janë hequr kanë të bëjnë me

Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA), paktit të parë kontraktual ndërmjet Kosovës dhe bllokut evropian, dhe Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Kosova ka synim të

kamotshëm anëtarësimin në BE, por ajo vijon të mbetet vendi i vetëm i Ballkanit Perëndimor që ende nuk e ka statusin e vendit kandidat. Kërkesa e saj për anëtarësim, e bërë në dhjetor 2022, nuk

është shqyrtuar ende. Ndërkohë, Osmani udhëtoi në Shtetet e Bashkuara këtë javë, ku zhvilloi takime edhe me zyrtarë të tjerë në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork. Të mërkurën ajo tha se pati bisedë "përmbajtjesore" me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Takimi i saj me Rubion vjen pasi marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara pësojnë një goditje në fillim të këtij muaji. Uashingtoni njoftoi më 12 shtator për pezullimin e Dialogut të planifikuar Strategjik për shkak të veprimeve të Qeverisë në detyrë të Kosovës, që tha se kanë rritur tensionet dhe paqëndrueshmërinë në vend. Osmani kishte shprehur "keqardhje dhe shqetësim të thellë" lidhur me vendimin e ShBA-së për pezullimin e Dialogut të planifikuar Strategjik. Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha më vonë se qeveria në detyrë ka "disa" dallime në qëndrime me ShBA-në, por nguli këmbë se raportet mes dy vendeve nuk janë prishur.


Gërvalla në takimin e vendeve të SEECP-së paraqiti rezultatet e Kosovës në reforma dhe ekonomi

Prishtinë, 25 shtator - Zëvendëskryeministria dhe ministria në detyrë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla, ka marrë pjesë në drekën e punës të vendeve të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Në fjalën e saj, ministria Gërvalla paraqiti bilancin dhe rezultatet e matshme të Republikës së Kosovës, duke iu referuar Raportit të Komisionit Evropian 2024, i cili konfirmon përparim të Kosovës në 36 nga

gjithsej 38 fusha, përfshirë përparimin në sundimin e rendit dhe ligjit ku, sipas raportit Gallup Law & Order, Kosova renditet e para në Evropë dhe e treta në botë. Ministria Gërvalla, po ashtu, theksoi rritjen e qëndrueshme të ekonomisë së Kosovës, investimet e huaja direkte në nivele të larta, dyfishimin e eksporteve dhe forcimin e buxhetit shtetëror. "Ekonomi në rritje me investime të huaja rekorde, eksporte të dyfishuara

dhe buxhet të forcuar. Agjenda e Reformave për vitet 2024-2027 është e harmonizuar me Planin e Rritjes së BE-së, është në përputhje të plotë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Kosova ka afirmuar mbështetje të palëkundur për Ukrainën dhe bashkëpunon ngushtë me NATO-n, KFOR-in dhe BE-në". Ministria Gërvalla shtoi se Republika e Kosovës, në rolin e kryesueses së CEFTA-s, ka punuar për barazi në

përfaqësim, ka zbatuar kornizën e Tregut të Përbashkët Rajonal në kuadër të Procesit të Berlinit dhe Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC), si dhe ka kontribuar në zbatimin me sukses të procesit të emërimit të drejtorit ekzekutiv të CEFTA-s. Gjithashtu, ajo ngriti si shqetësim ndalesat arbitrare të Serbisë ndaj qytetarëve të Kosovës, duke theksuar se këto veprime cenojnë rëndë lirinë e lëvizjes dhe bien ndesh me



frymën e bashkëpunimit rajonal. Ministria kërkoi heqjen e këtyre masave të pajustificuara, trajtim të barabartë për statusin e kandidatit dhe përmbylljen sa më të shpejtë të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.



FAMILJET NË KOSOVË, NËN PRESIONIN E INFLACIONIT

Familjet në Kosovë po përballen me rritje të lartë të çmimeve, duke shpenzuar më shumë, por duke blerë më pak. Pensionistët dhe familjet me të ardhura të ulëta janë më të prekur nga rritja e çmimeve - shpesh të detyruar të heqin dorë nga produktet e caktuara ose t'i shtyjnë pagesat e domosdoshme. Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se inflacioni, që reflekton rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve, është rritur për 4.5 % në gusht krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Teuta Halimi, rreth të 40-tave, hap derën e dyqanit dhe del me pak gjëra. Çmimet janë rritur aq shumë sa që çdo javë thotë se i duhet ta shkurtojë listën e blerjeve. Jeton në Prishtinë me bashkëshortin dhe dy fëmijët, punon në sektorin publik dhe merr një pagë prej rreth 630 eurosh në muaj. “Qumështi, vaji, kafeja, sheqeri - të gjitha janë shtrenjtuar. Për t'i mbuluar vetëm gjërat bazike, do të duheshin tri paga”, thotë Teuta për Radion Evropa e Lirë. Bashkëshorti i saj punon, por pagat e tyre shkojnë pothuajse tërësisht për ushqime dhe fatura, duke e bërë çdo muaj sfidë për familjen. “Po shpenzojmë më shumë, por po blejmë më pak.

Pas 45 vjetësh punë, të varur nga ndihma e fëmijës

Pensionistët dhe familjet me të ardhura të ulëta janë më të

prekur nga rritja e çmimeve - shpesh të detyruar të heqin dorë nga produktet e caktuara ose t'i shtyjnë pagesat e domosdoshme. Xhynaze Hima dhe Muharrem Vataj kanë punuar për rreth 45 vjet, por sot jetojnë me dy pensione që bashkë kanë vlerën e 440 eurove. “Në përgjithësi, ushqimet janë shtrenjtuar pa masë dhe pa kontroll. Sot qumështi ka një çmim, nesër krejt tjetër”, thotë Muharremi, ndërsa bashkë me Xhynazen qëndrojnë të ulur në një park në kryeqytet. Edhe ky çift thotë se përpiqet të kursejë duke blerë kryesisht gjatë aksioneve në dyqane. Por më e dhimbshmja, thotë Xhynazja, është se, pas gjithë viteve të punës, tani janë të detyruar të varen nga ndihma e vajzës së tyre që jeton në Shtetet e Bashkuara. “Na vjen keq për të. Ne kemi kontribuar gjithë jetën, e tani pensioni nuk na mjafton. Vajza na thotë: ‘Mos u mërzisni, kërkonti çfarë ju nevojitet’...”, rrefen Xhynazja.

Rritje e inflacionit

Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se inflacioni, që reflekton rritjen e çmimeve të

produkteve dhe shërbimeve, është rritur për 4.5 % në gusht krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja më e ndjeshme u regjistrua tek energjia elektrike, 17 %, e ndjekur nga produktet ushqimore dhe pijet joalkoolike, që u shtrenjtuan për 9.2 %. Për shembull, në gusht të vitit 2024 një litër vaj kushtonte 1.43 euro, krahasuar me 1.66 euro muajin e kaluar, ndërsa pakot e vezëve u shtrenjtuan nga 2.50 euro në 3.55 euro. Profesori i Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, Arbër Hoti, thotë se inflacioni nuk është thjesht një shifër statistikore - ai përkthehet drejtpërdrejt në qytetarëve. “Me çdo euro që një familje fiton sot, blen më pak produkte dhe shërbime sesa blinte një vit apo dy vjet më parë”, thotë Hoti për Radion Evropa e Lirë. Inflacioni në Kosovë kulmoi në mbi 14 % në vitin 2022, pas krizës së tregjeve që pasoi luftën në Ukrainë. Ai ra gradualisht duke arritur një mesatare vjetore prej rreth 2 % vitin e kaluar, por tani është rikthyer në rreth 4-5 %. Hoti thotë se Kosova është veçanërisht e ndjeshme ndaj inflacionit, pasi shumica e produkteve konsumohen nga

importet - duke importuar indirekt edhe rritjen e çmimeve jashtë. “Pasojat për qytetarët janë të prekshme: standardi i jetesës ka rënë, shporta e konsumit është ngushtuar, artikujt joesencialë kanë dalë nga lista dhe pasiguria ekonomike është rritur. Kjo e bën të vështirë planifikimin, kursimet dhe investimet afatgjatë, si blerja e një banese apo njsja e një biznesi”, thotë Hoti. Në anketën e realizuar nga IRI, shumica e qytetarëve të anketuar në Kosovë e kanë përshkruar gjendjen e tyre ekonomike si “disi të mirë”. Një hulumtim i publikuar vitin e kaluar nga Instituti për Politika Sociale në Prishtinë “Musine Kokalari” ka gjetur se një familje katëranëtarëshe në Kosovë shpenzon mesatarisht mbi 1 100 euro në muaj për ushqim, strehim, arsim, shëndetësi dhe transport. Në zonat urbane shpenzimet arrijnë mbi 1 200 euro, ndërsa në ato rurale rreth 1 090 euro. Paga mesatare bruto vitin e kaluar ishte 639 euro, ndërsa paga minimale 350 euro. Sipas hulumtimit, vetëm një në pesë paga mund të konsiderohej pagë jetese. Por, edhe me rritjet e këtij viti, që

ROHDE: KOSOVA DUHET TË TREGOJË SERIOZITET PËR DETYRIMET NË DIALOG, TA NISË ZBATIMIN E ASOCIACIONIT

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ish-ambasadori gjerman në Kosovë, i cili përfundoi mandatin gjatë këtij muaji, Jörn Rohde, ka deklaruar se Kosova është e detyruar fillimisht ta konstitujë Kuvendin dhe ta formojë qeverinë e re, pasi qytetarët kanë pritur tashmë tetë muaj që dikush t'i përfaqësojë. "Qytetarët e Kosovës kanë pritur për më shumë se gjysmë viti që dikush t'i përfaqësojë ata, ndërkohë që vendi po humb ngadalë e gjithnjë e më shumë mbështetje financiare dhe politike, sa më gjatë që të mungojë përfaqësimi demokratik i tyre", ka thënë Rohde në një intervistë për "Kosovo Online".

Ai ka shprehur gatishmërinë që Gjermania dhe Bashkimi Evropian ta ndihmojnë Kosovën për të dalë nga kjo situatë. "Gjermania dhe BE-ja janë të gatshme dhe të vullnetshme të ndihmojnë, por Kosova duhet të tregojë më parë se e merr seriozisht dialogun dhe detyrimet e saj drejt normalizimit, siç është fillimi i zbatimit të marrëveshjes

për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe".

Gjithashtu, ambasadori ka kërkuar nga të dyja palët, Kosova dhe Serbia, t'i përmbushin obligimet e tyre të dala nga marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut. "Secila palë në dialog duhet ta bëjë pjesën e saj dhe t'i përmbushë detyrimet që i takojnë. Kosova është, mbi të gjitha, e detyruar ta krijojë Kuvendin dhe ta formojë qeverinë e re".

Lista Serbe, partia më e madhe serbe në Kuvend, më 30 gusht paraqiti ankesë në Gjykatën Kushtetuese për mënyrën e votimit të nënkryetarit serb, duke kritikuar veprimin e Bashës, i cili hodhi në votim ndaras kandidatët e pakicave dhe përdori shortin për kandidatët serbë. Pas kësaj, Kushtetuesja vendosi masë të përkohshme që ndalon çdo veprim për formimin e qeverisë. Kjo masë, që hyri në fuqi më 5 shtator, do të zgjasë deri më 30 shtator. Ky vendim u cilësua i njëanshëm nga Lëvizja Vetëvendosje, partia që mori më



shumë vota në zgjedhjet e 9 shkurtit. "Gjykata Kushtetuese që nga fillimi ka mbajtur anë me këtë vendim. Ndalimi i punës së 120 deputetëve është në kundërshtim të plotë me funksionalizimin e njërit prej institucioneve më të rëndësishme të shtetit, siç është Kuvendi", deklaruan nga LV-ja

përmes një komunikate për medie.

Lista Serbe kishte propozuar vetëm Sllavko Simiçin për nënkryetar, por ai nuk arriti t'i sigurote 61 votat e nevojshme në asnjë nga tre raundet e votimit. Për këtë arsye, Basha përdori shortin për dhjetë deputetët

serbë - nëntë nga Lista Serbe dhe një nga Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë.

Më 1 shtator Basha thirri një mbledhje të Kryesisë së Kuvendit për të diskutuar për funksionimin e institucionit, por ajo nuk u zhvillua për shkak të mungesës së kuorumit.

BEGAJ NË OKB: ANËTARËSIMI I KOSOVËS ËSHTË AKT DREJTËSIE

Prishtinë, 25 shtator - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka bërë thirrje që Kosova të mbështetet në synimet e saj për t'u bërë anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) gjatë një fjalimi në Asamblenë e Përgjithshme të mërkurën vonë. "Kontributi i saj [Kosovës] për bashkëpunim rajonal dhe më të gjerë është i pamohueshëm dhe, prapëseprapë, ulësja e Kosovës në këtë Asamble mbetet padrejtësisht e zbrazët", tha Begaj gjatë fjalimit të tij.

Ai tha se njohja e pavarësisë së Kosovës dhe mbështetja për anëtarësimin e saj në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare "është akt drejtësie" dhe hap drejt konsolidimit të paqes në Ballkanin Perëndimor. "Shtatëmbëdhjetë vjet pasi e shpalli pavarësinë, Kosova ka dëshmuar përmes veprimeve të saj se është anëtare e përgjegjshme e bashkësisë ndërkombëtare, e përkushtuar ndaj paqes dhe stabilitetit dhe vlerave demokratike, me institucione të fuqishme", shtoi Begaj.



Qëkurse e shpalli pavarësinë nga Serbia më 2008, Kosova është njohur nga 119 shtete, shumica e tyre anëtare të OKB-së. Për anëtarësim në OKB nevojitet rekomandim nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, duke pasur në mendje që asnjë prej pesë anëtarëve të përhershëm të

këshillit nuk e përdor veton, dhe rekomandimi duhet t'i marrë votat e një shumice prej dy të tretave në Asamblenë e Përgjithshme.

Anëtarësimin e Kosovës në OKB e bën tejet të vështirë fakti se dy nga pesë anëtarët e përhershëm me të drejtë vetoje, Kina dhe Rusia, nuk

e njohin pavarësinë e saj dhe janë mbështetëse të Serbisë.

Serbia e lufton anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare sepse vazhdon ta cilësojë atë si pjesë të veten. Këtë qëndrim e përsëriti të mërkurën gjatë fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme presidenti serb

Aleksandar Vuçiq, i cili tha se Kosova është "pjesë e pandashme e Serbisë" dhe "shtylla kryesore e identitetit, kulturës dhe trashëgimisë shpirtërore" të Serbisë.

Ndërkohë, Begaj foli edhe në mbështetje të Ukrainës në përpjekjet e saj për ta luftuar pushtimin nga Rusia. Ai tha se "për gati katër vjet, besueshmëria e organizatës sonë është vënë në provë nga agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës".

Begaj i dënoi shkeljet e Moskës ndaj Kartës së OKB-së dhe të së drejtës ndërkombëtare, duke shprehur mbështetje për përpjekjet diplomatike që synojnë paqen. Duke theksuar se Shqipëria është "më afër se kurrë" për ta realizuar ëndrrën e saj të hershme për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, ai tha se synon t'i përfundojë negociatat deri në vitin 2027 dhe të bëhet anëtare e plotë e bllokut deri në vitin 2030. Shqipëria këtë muaj i hapi edhe disa kapituj në bisedimet për anëtarësim në BE, duke e çuar në 28 nga 33 gjithsej numrin e kapitujve të hapur.

e kanë çuar pagën mesatare në rreth 865 euro, shumica e familjeve nuk arrijnë t'i mbulojnë kostot bazike të jetesës. Sipas profesorit Hoti, ky hendek mes të ardhurave dhe shpenzimeve ushtron presion të vazhdueshëm mbi buxhetet familjare, duke shtuar borxhin konsumator dhe duke vështirësuar pagesën e qirasë, kredive dhe shërbimeve. "Kjo gjendje krijon stres financiar, cenon mirëqenien mendore dhe dëmton marrëdhëniet sociale,

duke krijuar ankth dhe pakënaqësi të thellë në shoqëri", thotë Hoti.

Cila është zgjidhja?

Hoti thotë se për t'u përballur me presionin e rritjes së çmimeve, nevojitet një qasje e koordinuar mes institucioneve dhe familjeve. Sipas tij, asistencë sociale duhet të zgjerohet, të digjitalizohet dhe të përshtatet me inflacionin. Subvencionet e përgjithshme thotë se duhen

shmangur dhe të garantohet mbrojtja e konsumit bazë të energjisë për familjet më të ndjeshme.

Po ashtu, kërkohet investim në efikasitet - nga izolimi i banesave deri te pajisjet kursyese - si dhe forcim i konkurrencës në treg për t'i frenuar abuzimet me çmime, sidomos në sektorin e ushqimit dhe energjisë, shpjegon Hoti. "Qytetarët nuk mund ta zgjidhin vetë inflacionin - kursimi është vetëm mbrojtje, jo zgjidhje", shton ai.

Hoti thekson se është detyrë kushtetuese dhe morale e institucioneve që të krijojnë një mjedis ekonomik të qëndrueshëm, ku qytetarët nuk detyrohen thjesht të "mbijetojnë", por të kenë mundësi të "jetojnë" dhe të ecin përpara.

Qeveria në detyrë e Kosovës nuk është përgjigjur në pyetjet e Radios Evropa e Lirë nëse po shqyrton masa konkrete për të lehtësuar këtë barrë. Më herët, zyrtarë të saj kanë thënë se

Kosova ka ekonomi të lirë të tregut dhe se institucionet e saj nuk mund ta kontrollojnë lëvizjen e çmimeve.

Në disa raste ajo ka ndarë subvencione si për energji elektrike apo për pajisje eficiente të ngrohjes. Për Teutën, zgjidhje është rritja e pagave. "Çmimet e produkteve në tregun e Kosovës janë të njëjta si në tregun evropian, kështu që edhe pagat duhet të jenë në nivelin e pagave evropiane - mbi 1 000 euro", përfundon ajo.

AUDITIMI EVIDENTON MANGËSI NË OFRIMIN E TË DHËNAVE CILËSORE NË SISTEMIN E INFORMACIONIT TË TATIMIT NË PRONË

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka realizuar auditimin e Teknologjisë së Informacionit të Tatimit në Pronë (SITP) për periudhën 2024-korrik 2025 i cili ka vlerësuar nëse ky sistem siguron të dhëna cilësore, të sakta dhe të besueshme. Rezultatet e auditimit tregojnë se ky sistem nuk garanton plotësisht ofrimin e të dhënave cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Dobësitë në zhvillim dhe funksionim të sistemit, mungesa e procedurave të standardizuara për testim dhe aprovime, si dhe kontrollet e pamjaftueshme, kanë ndikuar

negativisht në integritetin e të dhënave dhe menaxhimin efikas të tatimit. Kjo ka rritur rrezikun për pasaktësi në llogaritje, shpërndarje të gabuar të pagesave dhe vështirësi në identifikimin e saktë të tatimpaguesve. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila menaxhon SITP, nuk siguron që zhvillimet e realizuara në këtë sistem arrijnë qëllimin, pasi ka mungesë të procedurave për kontrolle të brendshme funksionale lidhur me menaxhimin e ndryshimeve dhe trajtimin të kërkesave për zhvillim. Mungesa e kontrolleve hyrëse në aplikacion për SITP ka krijuar rreziqe për saktësinë e të dhënave dhe integritetin e shërbimeve. Auditimi ka evidentuar mangësi në



ndërlidhjen e sistemit me regjistrin e të dhënave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës si dhe ndërlidhjes me Sistemin e Anketimit. Kjo ka rezultuar me të dhëna të pasakta për tatimpaguesit dhe pronat. Mangësitë në kontrollet e përpunimit kanë shkaktuar mosshpërndarjen e pagesës në mënyrë proporcionale dhe në borxhe të pasakta për qytetarët

duke i dëmtuar me ndëshkime dhe interes. Po ashtu, SITP ka mangësi në regjistrimin e pagesave, duke mos regjistruar datën e saktë të tyre, nuk e pasqyron gjendjen reale të faturës si dhe nuk ka pasqyrim dhe zbatim të saktë të kërkesave ligjore dhe rregullative. Për rrjedhojë, qytetarët mund të penalizohen me interes pavarësisht prej

pagesës së realizuar në kohë. Gjithashtu, proceset manuale rrisin rrezikun e gabimeve dhe humbjes së të dhënave jashtë sistemit. Mangësitë në kontrollet e sigurisë bëjnë më të cenueshëm SITP ndaj keqpërdorimeve të sigurisë. Lidhur me këtë auditim, auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, theksoi se Sistemi i Informacionit të Tatimit në Pronë ka transformuar administrimin e tatimit në pronë duke e bërë më të menaxhueshëm, por nuk garanton plotësisht të dhëna cilësore, të sakta, të plota dhe të besueshme. Për t'i përmirësuar çështjet e identifikuar në këtë sistem, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 14 rekomandime.

BASHA THOTË SE JANË LARGUAR KAPITULLI DHE BASHKAUTORËSIA NGA PUNIMI QË FLISTE KUNDËR UÇK-së

Prishtinë, 25 shtator - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, tha se me kërkesën e tij, është larguar kapitulli që ai kishte shkruar dhe i është hequr emri nga autorësia në një punim të vitit 2012 që fliste kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për këtë punim, ku Basha ishte bashkautor, raportuan mediet në Kosovë pasi ai u zgjodh kryetar i Kuvendit në gusht, duke nxitur reagime të shumta lidhur me përmbajtjen.

Basha ishte distancuar menjëherë, duke thënë se ai kishte shkruar vetëm Kapitullin 3 të punimit me titullin: "Globalizmi në Ballkanin Perëndimor: Krimi transnacional, islami fundamentalist dhe aleancat e padrejta". Kapitulli 3 fliste për islamizmin radikal në Evropën Juglindore.

Në njoftimin e publikuar në "Facebook" mbrëmjen e 24 shtatorit, Basha tha se ai gabimisht ishte listuar bashkautor i punimit, pasi



rikthesoi se ai kishte kontribuar vetëm për Kapitullin 3. "Komiteti i Publikimeve i Revistës në fjalë sot më ka njoftuar që ka miratuar kërkesën time për tërheqjen e Kapitullit 3 nga publikimi dhe, gjithashtu, ka hequr edhe emrin tim nga autorësia, meqenëse unë nuk kam autorësi në pjesën tjetër të publikimit, përveç Kapitullit 3 i cili tashmë është tërhequr", shkroi Basha.

Raportimi për këtë punim, ku Basha ishte bashkautor, nxiti reagime të shumta nga shoqëria

civile, politikanë dhe nga Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila ka kërkuar që Basha të shkarkohet nga pozita e kryeparlamentarit.

Çfarë thuhet në punimin e vitit 2012?

Në këtë punim, ku Basha dhe Jana Arsovska ishin të listuar si bashkautorë, thuhet se, "sipas rasteve të hetuara, fondet për UÇK-në erdhën nga shqiptarët të

zakonshëm në diasporë, por edhe nga trafikantët e drogës që operonin në gjithë Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara".

Në punim, po ashtu, thuhet se, përveçse UÇK-ja ishte "financuar nga trafikantët e drogës", mbështetja nuk përfshinte vetëm para. "Por, trafikantët e drogës dërguan persona të armatosur për të luftuar së bashku me UÇK-në dhe blinin armë në emër të UÇK-së". "Teksa lidhja midis UÇK-së dhe krimit të organizuar është e vështirë për t'u matur, ekzistojnë raste gjyqësore të njohura nga Gjermania, Italia, Belgjika dhe Republika Çeke, të cilat sugjerojnë fuqishëm një lidhje midis trafikantëve të drogës dhe UÇK-së", u tha në këtë punim. Sipas punimit, në Belgjikë bos i "së ashtuquajturës mafi shqiptare la fishekë para dyerve të anëtarëve të diasporës shqiptare si kujtesë se taksat 'vullnetare' që ata kishin paguar për mbështetjen e qeverisë në

hije dhe UÇK-në, në të vërtetë nuk ishin 'vullnetare'".

Punimi pretendon se mbijetesa e UÇK-së "varej nga financimi që ofronin banditët patriotë, që operonin përtej kufijve. Të ashtuquajturat taksa vullnetare u dërgoheshin organizatave humanitare sikurse Vendlindja Thërret".

Në punim lufta në Kosovë më 1998-99 vlerësohet si "konflikt etnik", teksa aty pretendohet se agjencitë perëndimore të inteligjencës "shpesh mbyllën sytë ndaj bashkëpunimit mes krimit dhe politikës në Kosovë". "Që nga fillimi i viteve 1990 shumë ishin të vetëdijshëm për lidhjen midis UÇK-së dhe trafikantëve të drogës. Pas konfliktit, UÇK-ja vetë u shpërbë formalisht, megjithatë shumë ish-komandantë të UÇK-së u përfshinë në politikë. Me politikën erdhi edhe krimi", thuhet në këtë punim.

UÇK-ja ishte forcë politiko-ushtarake e cila ka luftuar për çlirimin e Kosovës nga sundimi serb në periudhën 1990-1999.

Disa prindër ende pa pagesa për tekstet shkollore, MASHTI hesht për vonesat

Prishtinë, 25 shtator - Gati një muaj pas fillimit të vitit të ri shkollor 2025/26, shumë prindër ende nuk i kanë marrë mjetet financiare për tekstet shkollore. Në redaksinë e "Telegrafi"-t kanë mbërritur disa ankesa nga qytetarë, të cilët shprehen se pagesat nuk janë ekzekutuar ende, duke u shkaktuar kështu vështirësi financiare në përballimin e shpenzimeve shkollore për fëmijët e tyre.

Lidhur me këtë situatë, "Telegrafi" ka dërguar pyetje në Ministrinë e Arsimit, Shkencës

dhe Teknologjisë, por deri në momentin e publikimit të këtij artikulli, nuk ka marrë ndonjë përgjigje zyrtare. Po ashtu, redaksia ka tentuar të kontaktojë edhe ministrin në detyrë të Arsimit, Arbërie Nagavci, por e njëjta nuk ka kthyer përgjigje. Ministrija Nagavci nuk ka bërë asnjë deklaram publik kohët e fundit për ecurinë e procesit të subvencionimit të teksteve shkollore dhe nuk është e qartë nëse ky proces është përmbysur me sukses.

Në postimet e saj të fundit në rrjetet sociale, vërehet se ajo e ka

përqendruar vëmendjen kryesisht në fushatën zgjedhore për zgjedhjet e 12 tetorit.

Më 25 gusht Nagavci kishte bërë me dije se pagesat e para për tekstet shkollore ishin ekzekutuar, por që nga ajo ditë nuk është dhënë asnjë njoftim tjetër zyrtar në lidhje me vazhdimin e procesit.

Disa ditë më parë qeveria në një mbledhje të mbajtur njoftoi se ka ndarë mbi dy milionë euro për Ministrinë e Arsimit me qëllim të përmbysjes së këtij procesi të subvencionimit të teksteve shkollore.



Zyrtarë policorë nga Drejtoria e Policimit në Bashkësi vazhdojnë të realizojnë takime me komunitetin

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Zyrtarë policorë nga Drejtoria e Policimit në Bashkësi dhe Parandalim, mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, kanë realizuar sesionin e pestë sensibilizues/vetëdijesues me temën "Edukimi i nënave mbi shenjat e hershme të ekstremizmit dhe radikalizmit në familje".

Takimet u mbajtën me gratë e fshatit Krajk dhe me anëtarët e Këshillit Lokal për Siguri Publike (KLSP) Velezhë, komuna e Prizrenit, në kuadër të një

inicative për parandalimin e ekstremizmit dhe radikalizmit në familje dhe komunitet. Sesioni u mbajt në ShFMU "Mid'hat Frashëri".

Qëllimi i sesionit ishte ta risë ndërgjegjësimin e grave për faktorët dhe shenjat e hershme të ekstremizmit dhe ta fuqizojë rolin e tyre në mbrojtjen e sigurisë dhe stabilitetit në familjet e tyre dhe rrethin ku jetojnë.

Gjatë sesionit u diskutuan praktika dhe masa për

identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve radikale si dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe institucioneve të sigurisë për një mjedis më të sigurt.

Policia e Kosovës falënderon të gjitha gratë pjesëmarrëse dhe anëtarët e KLSP-së për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre, duke theksuar se roli i tyre është thelbësor në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe paqësore.



ZGJEDHJET LOKALE KUSHTËZOJNË REZULTATIN E ATYRE PARLAMENTARE



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Balotazhe mbi 70 për qind: Fushata për zgjedhje lokale të 12 tetorit zyrtarisht ka filluar para 12 ditëve, realisht ka filluar shumë më herët. Në qytete të mëdha dhe në "bastione" po kandidojnë ata që kanë fituar shumë vota në zgjedhjet parlamentare. Kjo, në asnjë mënyrë nuk nënkupton se votat e fituara në zgjedhje parlamentare do të përkthehen në vota të zgjedhjeve lokale aq më parë që votuesit janë të

mllefosur me pafuqinë e të zgjedhurve të popullit që në afatet e parapara kushtetuese të formojnë institucionet.

Edhe sot kemi vakum institucional, pa Kuvend dhe qeveri funksionale. Presidenca dhe presidentja janë zgjatje e LV-së, pa identitet dhe përmbajtje vendimmarrëse. Në këto zgjedhje lokale në vend se të bëhet fushatë për përmirësimin e infrastrukturës jetësore të qytetarit, fort po i bien tupanit patriotik që asgjë nuk ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Të shohim qendrat e mëdha.

1. Në Prishtinë janë tre lojtarë për udhëheqësin e ekipit që do ta udhëheq Prishtinën në mandatin që po vjen: Përparim Rama, Uran Ismaili dhe Hajrullah Çeko. Të tjerët më shumë luftojnë për asamblistë se për kryetar. Nëse nuk ndodhë

ndonjë befasi apo zhvillim që tash nuk e shohim, Përparim Rama e ka të sigurt edhe një mandat tjetër, pas balotazhit.

2. Peja: Me siguri se këtu do të fitojë Gazmend Muhaxheri, nuk ka kundërshtar që e sfidon.

3. Gjakova: Ardian Gjini që tash mund ta festojë fitoren.

4. Ferizaj: Agim Aliu nuk diskutohet nëse do të fitojë. Këtu nuk do të ketë balotazh fare, është kryetar për të gjithë qytetarët pavarësisht cilës parti i takojnë. Është ndër kryetarët e rrallë që merr vota edhe nga partitë tjera. Ka bërë një punë shembullore në Ferizaj.

5. Prizreni: Nëpër vrimë të gjilpërës Shaqir Totaj, pas balotazhit do ta fitojë edhe një mandat.

6. Mitrovica: Fillimisht i kam dhënë përparësi Faton Pecit, por se duket se nuk do të fitojë. Ka reputacion të keq, është

arrogant dhe shpërfillës. Armend Muja do të kishte më shumë gjasë për fitore. Pastaj, Pecit i rri mbi kokë Prokuroria Speciale si shpata e Demokleut.

7. Gjilani: Nëse shkohet në balotazh, LDK-ja do ta fitojë këtë qendër të madhe.

Kush rritet e kush xhuxhavit: Parashoh që në këto zgjedhje lokale të rritet LDK-ja, ndërsa të tjerët nuk do të kenë ndryshime të mëdha.

LV -ja, duke i rënë fort "defit patriotik" në kohën kur patriotizmi nuk gjen rrugë drejt kësaj partie, luajti lojën e mbajtjes së dy palë zgjedhjeve të njëjtën ditë. Përpjekje manipulative që të shfrytëzohet diaspora edhe për zgjedhje lokale. Nuk u bë kjo prandaj LV-ja në të gjitha komunat që do të shkojë në balotazh do të ndahet humbëse.

PDK-ja ia theu këmbët vetes në

Drenas dhe Kaçanik, pa asnjë nevojë. E ka në dorë shpatën me dy tehe, sa mund të presë elektoralisht kundërshtarët, mund ta presë edhe veten.

Nëse në Podujevë shkohet në balotazh, fituese do të jetë LDK-ja. Besnik Osmani e fiton Fushë-Kosovën sepse ka përvojë të gjatë, është korrekt dhe i ndershmë.

Xhafer Gashi me siguri e fiton Obiliqin sikur që besoj se edhe Smajl Latifi fiton në Rahovec, pa asnjë dyshim të merituar.

Për komunat tjera, në shkrimet e radhës. Por, jam i sigurt se koalicionet në nivel lokal do të jenë përcaktues edhe për qeverinë e ardhshme. E shohim përmes përditësimit të zhvillimeve të radhës. Këto pikëpamje janë në vija të trasha por se përafërsisht kështu do të jetë gjeografia e pushtetit lokal pas zgjedhjeve të 12 tetorit 2025.

ZVOGËLOHET LISTA E PRITJES PËR OPERACIONE NË KLINIKËN E KIRURGJISË SË FËMIJËVE



PRISHTINË, 25 SHTATOR - "Janë zvogëluar listat e pritjes për operacione në Klinikën e Kirurgjisë së Fëmijëve në QKUK. Ky sukses është arritur falë punës, përkushtimit të stafit, por edhe mbështetjet nga institucioni", ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës. Derisa dikur lista e pritjes ishte mbi

një vit, tashmë kjo listë është nën 4 muaj falë përkushtimit nga 14 kirurgët e fëmijëve, anesteziologët dhe stafi tjetër i infermierëve dhe atyre mbështetës. "Në nëntëmuajorin e parë të këtij viti janë kryer mbi 1 mijë operacione, në dy salla të operacionit, ngase sallat e tjera nuk janë funksionalizuar për shkak të

mungesës së anesteziologëve. Salla e tretë përdoret kur ka nevojë për intervenime të Klinikës së Pediatriisë, Mjekimit Intenziv Pediatric, Neurokirurgjisë, ORL-së dhe klinikave të tjera, ndërsa në sallën e katërt kanë operuar mjekët amerikanë dhe turq për rastet kardiokirurgjike tek fëmijët, dhe këto shifra nuk janë përfshirë në

numrin e përgjithshëm të operacioneve. Në këtë klinikë ka vazhdimisht progres në zhvillimin e procedurave të reja diagnostike dhe terapeutike, tani punohet edhe me laparoskop një gamë e gjerë e operacioneve, po ashtu, litotripsia laserike, ureterorenoskopia, dhe së shpejti fillon endoskopia e traktit", ka njoftuar ShSKUK-ja.

Urdhër për sjellje me detyrim të Sveçlës, Pacollit e Zybës në seancën për gazin

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka urdhëruar të enjten Policinë e Kosovës t'i sjellë para trupit gjykues ministrin në detyrë të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, si dhe dy deputetët e Lëvizjes Vetëvendosjes Salih Zyba dhe Fitore Pacolli-Dalipi, të cilët, krahas ish-deputetes së Lidhjes Demokratike të Kosovës, Drita Millaku, janë subjekt i akuzave për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës në mars të vitit 2018.

Ky urdhër është lëshuar pas

mungesës së tre të pandehurve në seancën gjyqësore të mbajtur më 16 shtator 2025. Kjo do të thotë se Policia e Kosovës ka për detyrë ta zbatojë urdhëresën e gjykatës, duke i shoqëruar me detyrim tre të akuzuarit deri në sallën e gjyqit, në mënyrë që ata të jenë të pranishëm në seancën e radhës më 31 tetor, raporton Betimi për Drejtësi.

Gjykata e Prishtinës më 6 qershor 2024 ka konfirmuar aktakuzën ndaj Sveçlës, Millakut, Zybës dhe Pacolli-Dalipit, për hedhjen e gazit lotsjellës në

ambientet e organit ligjvënës, ndërsa vendimin e Gjykatës Themelores e vërtetoi Gjykata e Apelit.

Ky incident nuk është i pari në Kuvendin e Kosovës ngaqë institucioni më i lartë përfaqësues i vendit ka qenë shpeshherë arenë e tensioneve që kanë degjeneruar në përlëshje fizike, përpjekje për sulme dhe skena të tjera dhune. Përveç hedhjes së gazit lotsjellës, janë regjistruar raste kur deputetët kanë përdorur sprej piperi dhe vezë.



AKB-ja: 9 miliardë euro të diasporës janë futur në banesa, kapital i vdekur për ekonominë e Kosovës

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësim të thellë për mënyrën si po orientohen investimet e diasporës në Kosovë. Sipas kryetarit të AKB-së, Agim Shahini, vetëm gjatë dy dekadave të fundit diaspora ka futur mbi 9 miliardë euro në blerjen e rreth 180 mijë banesave në Kosovë. “Këto janë mjete kolosale, por të shndërruara në kapital të vdekur, që nuk krijojnë as vende pune, as zhvillim ekonomik, as të ardhura të reja për shtetin. Kjo shifër e lartë tregon qartë se Qeveria e Kosovës

nuk ka asnjë strategji të mirëfilltë për orientimin e remitancave dhe të kursimeve të mërgatës drejt sektorëve prodhues e shërbimorë. Në mungesë të lehtësirave, sigurisë dhe politikave shtetërore, diaspora zgjedh të investojë në pasuri të paluajtshme, duke humbur mundësinë e krijimit të kapitalit qarkullues që do t'i jepte frymëmarrje ekonomisë së vendit”, ka thënë ai. Shahini ka theksuar se AKB-ja konsideron se 9 miliardë euro në banesa janë një pasuri e madhe e



vendosur në vendin e gabuar mbi 50 %. “Përgjegjësia bie si mbi

qeverinë, e cila ka dështuar të krijojë kushte për investime të

shëndosha, ashtu edhe mbi diasporën që nuk po e shfrytëzon potencialin e saj për gjenerim të zhvillimit afatgjatë. AKB-ja kërkon nga qeveria hartimin e një strategjie të qartë dhe stimul realë për orientimin e remitancave në ekonomi aktive. Nga diaspora, një reflektim dhe angazhim më të madh për investime në biznese prodhuese, në shërbime, në teknologji dhe në projekte që gjenerojnë punësim e perspektivë për të rinjtë e Kosovës”, ka thënë kryetar i AKB-së, Agim Shahini.

PËRFSHIRJE E ULËT E GRAVE NË TREGUN E PUNËS

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Shkalla e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është rreth 25 për qind në Kosovë, prandaj kërkohet veprim i menjëhershëm e i bashkërenduar nga institucionet, sektori privat dhe vetë individët. Kështu u tha në diskutimin e organizuar nga Instituti Riinvest me temën “Zhbllokimi i potencialit: Kostoja ekonomike e potencialit të pashfrytëzuar të grave”. Në prezantimin e një raporti u tha se ndër pengesat kryesore që ndikojnë në moskryerjen e grave



në tregun e punës janë normat gjinore dhe stereotipat, përgjegjësitë e kujdesit, mangësitë gjinore të legjislacionit të punës dhe pjesëmarrja e ulët e grave në pozita vendimmarrëse.

Drejtori ekzekutiv në Institutin Riinvest, Alban Hashani, tha se hendeqet gjinore në pjesëmarrje dhe punësim në tregun e punës përbëjnë një nga sfidat më të mëdha strukturore në vendin tonë. Ndërkaq koordinatori i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Stephen O'Malley, tha se gratë shkëlqejnë në arsimin e lartë dhe në fusha të tjera të jetës por, megjithatë, siç potencoi ai, vetëm një në katër prej tyre merr pjesë në tregun e punës, që shënon shkallën më e

ulët në Evropë. Lidhur me raportin e Riinvest, O'Malley tha se tregon shumë qartë se si përjashtimi strukturor po e mban pas tërë ekonominë. Siç potencoi koordinatori i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara, Stephen O'Malley, duhet zhvilluar veprime të përbashkëta nëpërmjet politikave dhe normave shoqërore, praktikave të biznesit, për t'i sjellë të rinjtë dhe gratë plotësisht në fuqinë punëtore. Shefja e Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuara për

Popullsi (UNFPA), Visare Mujku, tha se shkalla aktuale e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore në Kosovë është vetëm 25 për qind. Ajo theksoi se kjo statistikë duhet trajtuar me urgjencë dhe se kërkon veprime të menjëhershme e të bashkërenduara nga institucionet, sektori privat dhe vetë individët. Mujku shtoi se ndër pengesat kryesore për këtë nivel kaq të ulët të përfshirjes së grave në tregun e punës janë faktorët socialë, kulturorë dhe strukturorë. (ksp)

PESHKU NË TREGUN E KOSOVËS NUK PARAQET RREZIK PËR SHËNDETIN PUBLIK

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka njoftuar se bazuar në vlerësimet shkencore të BE-së dhe legjislacionin përkatës të Republikës së Kosovës (Pikën D të Kapitullit III të Seksionit VIII të Shtojcës III të Rregullores nr. 12/2011 Për Përcaktimin e Rregullave Specifike të Higjienës së Ushqimit me Prejardhje Shtazore), produktet e peshkut të papërpunuar duhet të trajtohen në mënyrë adekuate për t'i eliminuar parazitët që mund të paraqesin rrezik për shëndetin e konsumatorit. Metodot e rekomanduara përfshijnë ngrirjen në temperatura të ulëta (-18°C) për periudha të caktuara dhe trajtimin termik në temperatura mbi 60°C, duke marrë parasysh llojin e parazitit dhe trashësinë e

produktit. “Në tregun e Kosovës, importet me ngarkesat me peshk nga ShBA, Kanadaja, Spanja, Kroacia, Maqedonia e Veriut, në Republikën e Kosovës vijnë të ngrira në më shumë se -18 C dhe me certifikata shëndetësore si garanci nga autoritetet e këtyre vendeve. Lloji i peshkut Merluc (hake), i cili gjendet në treg, është i destinuar për t'u gatuar dhe nuk shitet si produkt i freskët ose i shkrië për konsum pa trajtim të sigurt kundër parazitëve”, ka njoftuar AUV. Bëhet me dije se një komision i pavarur i AUV-së ka pasur parasysh praktikën e cilat përdoren në shtete të ndryshme evropiane, ku produktet e peshkut me praninë e parazitëve ose të patrajuara mjaftueshëm asgjësohen, për ta mbrojtur



shëndetin publik. “Duke u nisur nga kjo praktikë Komisioni ka marrë vendim për asgjësimin e peshkut, duke siguruar kështu sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

Për këtë çështje kemi edhe vendimin e Gjykatës Komerciale në Prishtinë - Dhoma e shkallës së dytë, sipas Aktvendimit nr. lëndës 2025:134825 të datës 12.09.2025 nr. dokumenti

07679680. Në respektim të këtij vendimi, AUV bashkë me kompaninë është duke bërë përgatitjet për asgjësimin e 35 170 kilogramëve peshk, për të garantuar sigurinë shëndetësore të konsumatorëve dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare. Ky proces është i rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit publik dhe integritetin e tregut ushqimor në Kosovë. Për më shumë, lloji i peshkut Merluc (hake) i cili gjendet në tregun e Kosovës për të cilin bëhet fjalë, përveç se është i ngrirë, i përket llojit i cili është i dedikuar për t'u përgatitur me trajtim të nxehtësisë (d.m.th të gatuhet), dhe jo të përdoret si i freskët apo i shkrië, në rast nuk paraqet rrezik për shëndetin publik”, ka njoftuar AUV.

Kryetari i OEK-ut paraqiti platformën digjitale AGRO B2B

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka mbajtur fjalimin gjatë prezantimit të platformës AGRO B2B, një kanal i ri për fuqizimin e prodhuesve vendorë dhe lidhjen e tyre me tregun vendor e ndërkombëtar.

Platforma u dedikohet ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme, startup-eve dhe agrobizneseve që shpesh përballen me sfida për t'u bërë pjesë e tregut. Përmes AGRO B2B, prodhimet e Kosovës - nga bimët mjekësore te pemët, deri te

frutat dhe perimet e përpunuara, do të marrin më shumë hapësirë dhe vlerë në treg. Rafuna tha se kjo platformë nuk është vetëm një vegël teknologjike, por një mekanizëm për zhvillim, punësim dhe mirëqenie.



MBI MENDËSINË ESKILIANE DHE ATË KANUNORE SHQIPTARE

Nga: Ndriçim KULLA

Janë pikërisht dy rite, ai i mortit në radhë të parë dhe ai i dasmës, si ndihmës i tij, ata që kanë qenë pikërisht prindërit e tragjedisë, prindër të mohuar padrejtësisht. Një udhëtim në gadishullin Ballkanik dhe prania në një rit mortor e pastaj në një dasmë, me shumë gjasë do t'i jepnin Nietzsches atë shkrepëtim mendimi për lindjen e tragjedisë më shumë se hulumtimet e teksteve antike. Këto dy rite, që janë kaq të ndryshëm e njëkohësisht aq të ngjashëm me njëri-tjetrin, kanë qenë institucioni kulturor publik kryesor i popujve ballkanas për mijëvjeçarë të tërë. E duke qenë kremtimet më tronditëse dhe më të përhapurat, këto rituale qenë njëherësh edhe shkolla e parë e edukimit estetik. Në asnjë rajon të botës, përveç Ballkanit, ato nuk janë më afër e më të ngjashme me shfaqjet teatrale.

Por, ngjashmëria e tyre ka qenë veçanërisht e fuqishme te grekët dhe shqiptarët. Për këta të fundit, një ritual mortor, nisur nga lloji i ceremonisë që njihet, nuk është gjë tjetër veçse një dasmë e kthyer me kokë poshtë. Madje, studiuesi gjerman Maximilian Lambertz tregon se ende dhe sot rituali i dasmës te shqiptarët është mbeturinë e skenarit të moçëm grek të rrëmbimit të gruas. Mënyra e ardhjes së krushqve, mënyra e pritjes, cilësimet për nusen dhe dhëndrin (ajo një thëllëzë viktimë, kurse ai një skifter rrëmbyes), të shtënat me armë, ndërrimi i rrugës së kthimit, rregullat e lëvizjes së karvanit të dasmorëve gjatë ecjes, argumenton ai, nuk janë veçse fazat e një rrëmbimi, me të vetmin ndryshim se tani historia nuk ndodh, por “luhet”. Akoma dhe më fort të ngjashme janë ritet e vdekjes. Kadareja përcakton se vajtoret janë sheshimi i parë i korit antik. “Po të kujtojmë se në greqishten e vjetër fjala ‘aktor’ është ‘hypocrites’ që do të thotë shtihan, hipokrit. Kujt më tepër se vajtoreve profesioniste, që e qanin të vdekurin, pa e pasur fis e gjak, mund t’u shkonte ky përcaktim?”. Ende dhe sot në gjuhën shqipe është në përdorim shprehja “e qarë me ligje”. Fjala ligj në shqip, përveç kuptimit ligj-lex-loi, kur kthehet në trajtën foljore, ligjëroj ka dy kuptime: fjalim emocional, zemër-ndezës dhe këndim mortor. Pra, kemi të bëjmë me një të qarë të shoqëruar me tekst dhe të kodifikuar sipas ligjeve, sipas rregullave. Të gjitha këto lidhen me një rit mortor të zakonshëm, por le të imagjinojmë se ç’ndodhte në një kremtim mortor të pazakonshëm, ku i vdekuri nuk është thjesht një i vdekur, por i

vrarë për arsye gjakmarrjeje, gjë aq e shpeshtë kjo në bjeshkët shqiptare. E, këtu hyjnë në raport rregullat kanunore, sipas të cilave vrasësi është i detyruar të marrë pjesë në varrimin e viktimës, madje edhe të ulet në tryezë, në shtëpinë e të vërit, për të ngrënë drekën e mortit. Është pak të thuhet se jemi afër dramës. Drama është e gjitha aty, duke i lidhur të gjitha me fijet e saj, si në një teatër total.

Të gjitha këto ngjashmëri, natyrisht që nuk janë një rastësi, përkundrazi janë dëftyesë të një mentaliteti të caktuar, që rrjedh nga përftimi i jetës dhe i vdekjes si një dukuri unike, me dy përmasa, që janë njëkohësisht të pranishme te njëra-tjetra. Po njëlloj, në themel të tragjedisë antike qëndron në shumicën e herëve një gabim fatal, një faj që kërkon shlyerje, një krim, një vrasje. Edhe vrasja kanunore e shqiptarëve, e ruajtur gjer në kohët e vona, e ka pasur në vetvete, të ngulitur, të skalitur, estetikën tragjike dhe njeriun me ndërgjegje tragjike, dy elementet bazë dhe të domosdoshëm të teatrit dramatik.

Në jetën reale, shtatorja, maska, guri i varrit, i vdekuri, ngritja e të vdekurit, vetë aktori që e shëmbëllen, të gjitha kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe me teatrin. Por, ishte pikërisht Eskili, më gjeniali i tragjedianëve të Greqisë antike, ai që ka meritën e madhe e të dukshme që t’i dëftojë një nga një e t’i pasurojë këto elemente. Le të kujtojmë këtu fantazmat, ëndrrat e natës, parandjenjat dhe ankthet që sipas mendësisë greke, por në të shumtën e rasteve edhe të shqiptarëve, ishin zona të ndërmjetme midis botës njerëzore dhe asaj hyjnore. Kadare tregon se, “siç e ka shpjeguar në mënyrë të shkëlqyer J. P. Vernant, në origjinën e hijes apo të fantazmës është guri i varrit. Guri i varrit, ashtu i gjatë dhe i ngritur përpjetë, tregonte se poshtë tij, nën tokë, ishte ai që kishte ikur, i vdekuri, ai që kishte ikur nga kjo botë, duke lënë në të shëmbëlltyrën e tij. Kësisoj, guri i varrit ishte përfaqësimi, dyzimi, hija e të vdekurit”. Në Greqi dhe në Shqipëri, njerëzit vazhdojnë të betohen “për këtë gur”, sepse në mendësinë e tyre guri, përgjithësisht, me peshën, heshtjen dhe ftohtësinë e tij, lidhej me vdekjen. Për ta çuar më tej idenë, edhe shprehja “i heshtur si gur varri” është kuptimplotë. Po sipas Kadaresë, “kërkesa për të mos qenë i heshtur, nuk mund t’i bëhet çdo sendi, por atij që e ka këtë mundësi, sepse guri i varrit mund të fliste, pikërisht pse ishte dyzimi, hija e dikujt”. E bëme një parantezë të tillë të shkurtër hyrëse, për të nisur një



paralelizëm tjetër akoma dhe më të madh, që dëshmon rrënjët më të vërteta të mentalitetit shqiptar, paralelizmin midis mendësisë eskiliane në lidhje me të drejtën dhe mendësisë kanunore në raport me të. Përveç motiveve dhe ideve që Eskili mori prej sofrës homerike dhe parahomerike, në të cilën futen me plot të drejtë zakonet më të moçme shqiptare, ai është autori i ideve të reja nistore, njëra prej të cilave, ajo e së drejtës, e përshkon si kryemotiv gjithë veprën e tij. Kjo është arsyeja kryesore pse për të gjetur gurrën e lashtë nga ku buruan ligjet dhe zakonet shqiptare, bashkë me mendësinë tonë juridike, duhet të zhytemi sa më thellë e të zbërthejmë dramat e tij, në afritë dhe përsiatjet që ato kanë me realitetin e trevës ku u ngjizën, pra sofrën ballkanike të shekujve përkatës dhe shekujve përpara tyre. Diçka e tillë haset qartë, jo vetëm te drama e tij “Persët”, ku ai trajton “të drejtën” e Greqisë. Përkundrazi, ai e shtriu dhe e universalizoi problemin e së drejtës, pasi çdo akt njerëzor, sipas tij, e shtrun një çështje të tillë. E drejta ose të drejtat, sipas Eskilit, bëhen disa herë të mjegullta, sepse ato janë në kundërti të vazhdueshme. Se ç’është e drejtë dhe e padrejtë nuk është përherë e lehtë të gjendet, por tragjiku i madh e përjashton mundësinë që ajo të gjendet njëkohësisht tek të dyja palët kundërshtare. Përkundrazi, ngulmon ai, i përket vetëm një ane. Por, risia dhe origjinaliteti i konceptimit të tij qëndron në dinamikën që i mvësh së drejtës. Për të, e drejta nuk është e palëvizshme, ajo mund të shtegtojë, të zhvendoset nga njëra palë te pala kundërshtare. Me fjalë të tjera, teprimi i mbrojtjes të së drejtës mund të çojë në padrejtësi ose në shtegtimin e së drejtës tek armiku yt. Kjo zhvendosje e së drejtës nga njëra palë te tjetra, më mirë se te kushdo tjetër është dëshmuar te popujt rrënjës ballkanas, midis

të cilëve gjakmarrja ka bërë kërdrinë me mijëra vjet. Tragjiku i madh grek jo vetëm e ka njohur, por është marrë thellë me të, dhe në kryeveprën e tij “Orestia”, na ka dhënë çelësin për të kuptuar se gjakmarrja ballkanase, e veçanërisht, gjakmarrja te shqiptarët, ku jetoi dhe më gjatë se tek të tjerët, s’ka qenë veçse një rreth i tmerrshëm, ku e drejta, duke u zhvendosur pa pushim nga njëri fis te tjetri, ushqente me gjak e mish të freskët “bishën” e vdekjes. Që Eskili është marrë aq shumë e aq madhërisht me të drejtën, dëshmon se ai ka pasur prirje ose më mirë një shpirt ligjvënësi. Te shumë popuj të vjetër është e njohur figura e poetit dhe e magut, që shpesh qëllonte të njehsohej te i njëjti njeri. Krahas tij, te ballkanasit e moçëm, duhet të ketë qenë edhe një figurë tjetër arketipale, po aq e rëndësishme, ajo e juristit. Thelbi i tij, njësoj si ai i poetit apo magut, ishte i lidhur me shpresën dhe tmerrin. Figura e juristit popullor, pushteti i të cilit nuk e kishte zanafillën te kurrfarë emërimi a trashëgimie, ka gjalluar deri vonë te shqiptarët. Në gjyqësitë kanunore, sidomos në vrasjet dhe në përcaktimin e huas së gjakut, ndërhyrja e tij ishte vendimtare. Këto vendime, zgjidhje, formula apo kompromise të shkëlqyera, kaluan gojë më gojë te shqiptarët, njëlloj si bëmat heroike. Në këtë kuptim, figura e gjyqtarit kanunor lidhet drejtpërdrejt me atë të poetit. Por, po aq ngushtë lidhej ajo me figurën e mjekut, përderisa në gjykimin e vrasjeve për gjakmarrje, në përcaktimin e së drejtës së gjakut ose të detyrimit për të dhënë gjakun, një rol të madh luante mendimi i mjekut, si p.sh., në rastin e shtrirjes së trupit të viktimës, goditjes nga shpina apo nga gjoksi, e deri te kryerja në raste të caktuara e autopsisë. Më tej, gjyqtari kanunor te shqiptarët përtej mosemërimit dhe moszgjedhjes

nga ndonjë tubim popullor e fitonte autoritetin dhe famën në mënyrë të ngadaltë, falë akteve dhe veprimeve të drejta, njëlloj si poeti apo magu dhe, në po të njëjtën mënyrë, në shtegtim, sepse si shumica e magëve dhe e poetëve, gjyqtarët ishin shtegtues dhe që nga larg u vinin ftesat për gjyqësi. Duke lexuar me kujdes veprën e Eskilit, mund të arrijmë në përfundimin se, sidomos tek “Orestia”, ai shfaqet si figura tipike e gjyqtarit shqiptar të gjakut. Përpara se të gjejmë mjaft pika takimi me këtë kryevepër, le të heqim një vijë më të thjeshtë paralelizmi me një tjetër vepër eskiliane. Mospranimi te drama “Lutëset” e 50 vajzave të Danait, për t’u martuar me kushërinjtë e tyre të afërt është dëshmi e një reagimi të gjatë shumëshekullor kundër martesave brenda fisit, pra kundër endogamisë, një histori kjo e pafundme e shkëputjes së njerëzimit prej poligamisë. Një legjendë shumë e më vonshme dhe mjaft e përhapur te të gjithë popujt ballkanikë, ajo e ngritjes së vëllait prej varrit për të sjellë motrën e martuar larg, është një jehonë e gjallë e këtij shqetësimi. Grindja nënë e bir me të cilën nis balada ballkanase, njëra nga më të bukurat e letërsisë gojore botërore, ngadhnjimi i përkohshëm i mendimit të vëllait për ta martuar motrën larg, pendimi i më vonshëm i nënës, mallkimi i saj dhe ngritja e vëllait nga varri për të qortuar atë që kishte bërë, dëshmon se nëpër ç’trandje dhe zigzage ka kaluar njerëzimi për të mbërritur tek ajo që sot ne na duket si e vetmja zgjidhje natyrore, qoftë nga ana shoqërore, ashtu dhe gjenetike: martesa jashtë fisit. Është ky një fakt domethënës që mund të arrijë të thyejë shumë heshta armiqësie dhe sulmesh për primitivitetin e popujve dhe të ligjeve që i detyronin këto praktika. /Gazeta Panorama/

KANUNI I LEK DUKAGJINIT DHE NJOHJA E TIJ PREJ SHTETIT TË VENEDIKUT

Albert VATAJ

Kanuni i shqiptarëve është një kryemonument juridik zakonor i kombit tonë në Mesjetë. Ky korpus rregullash dhe MoikomZeço-2ligjesh të plotfuqishme është një botë e gjallë dhe njëkohësisht e fosilizuar e mendësisë popullore, e mençurisë së zgjidhjes së problemeve të mprehta dhe e një vetadministrimi të problemeve shoqërore.

Kanuni i shqiptarëve i njohur në Veri edhe me emrin konvencional si Kanuni i Lekë Dukagjinit, është mbledhur nga At Shtjefën Gjeçovi dhe është botuar jo vetëm në shqip, por në disa gjuhë kryesore të botës. Studiuesit e së drejtës kanë bërë shumë analiza për tekstin fragmentar dhe jo të plotë të Kanunit.

I mbledhur vonë dhe i kompozuar në mënyrë subjektive sipas mbledhësve, Kanuni nuk na paraqitet plotësisht dhe në mënyrë të pacenuar siç ka qenë para shumë shekujve. Ky Kanun është një nga kryeveprat mendore të kombit shqiptar në të gjitha kohërat.

Me të drejtë, Kanuni i Lekë Dukagjinit është një monument i traditës, i ndërlidhur ngushtë me Eposin e Kreshnikëve të Veriut si dhe konstelacionin e mrekullueshëm dhe të pashembullt të proverbave shqiptare. Gjithashtu, ky Kanun nuk mund të kuptohet pa gjenezën e kodeve juridike të perandorit ilir të Bizantit, Justinianit të Madh. Pra, nisma e Kanunit është fundi i Antikitetit të Vonë dhe plotfuqishmëria e Kanunit është periudha e Mesjetës së hershme etj.

Kanuni i Lekë Dukagjinit është kodi konceptual vetëqeverisës i shqiptarëve në atë që quhet epoka parashtetërore. Vetvetiu, struktura e një shteti është diçka krejt tjetër dhe do të krijojë kështu një paradoks dhe kundërvënien të juridicitetit parashtetëror me juridicitetin shtetëror. Kjo formulë e thënë nga studiuesit nuk është e saktë në mënyrë absolute. Shumë elementë përbërës të kodit juridik parashtetëror të shqiptarëve reflektojnë qenësinë e një autonomie shtetërore, ndoshta fjala vjen, e Shtetit të Parë të Arbërit ose dhe e principatave shqiptare të Veriut. Duke respektuar deri në fund Gjeçovin e madh, ne duhet t'i shtrijmë hulumtimet tona në shekujt e mëparshëm. Ka qenë një befasi e madhe kur, duke shfletuar disa libra botuar nga Instituti i Studimeve Shqiptare, me titull: "Studime dhe tekste", botuar më 1944, gjeta një studim relativisht të gjatë, botuar në italishten venedikase. Ky studim nuk ka emrat e autorëve. I takon si kohë shekullit të XVII.

Për herë të parë është transkriptuar në gjuhën shqipe nga miku im, mesjetarologu i

shquar, i ndjeri Injac Zamputi. Pikërisht ky studim hap një faqe të re krejtësisht origjinale për studimet mbi Kanunin. Duke lexuar këtë studim habitesh jo vetëm me arsyetimin e lartë juridik të përpiluesve me sa duket venedikas, ka mundësi edhe shqiptarë që shërbenin në Venedik, mbi Kanunin Shqiptar. Studimi i drejtohet Republikës së Venedikut dhe quhet "Informacion mbi origjinën dhe metodën e arbitrazhit në çështjet e marrjes së gjakut në Shqipëri". Arsyeja bazë e studimit është që të bëhet harmonizimi midis ligjeve të Kanunit Shqiptar dhe ligjeve shtetërore të Venedikut. Pikërisht në tokat shqiptare nga Kotorri e deri në Shkodër, që ishin në zotërim të Venedikut.

Ky material analizues e i pashembullt i para 4 shekujve na lejon të kuptojmë forcën, por dhe dobësinë e Kanunit Shqiptar edhe në ditët e sotme. Si arsyetohet dhe si bëhet argumentimi i këtij studimi? Që në fillim theksohet se grindjet ndërmjet privatëve gjykohen në dy mënyra, ose duke iu drejtuar autoritetit të ligjshëm të popullsisë, ose duke ia lënë në dorë drejtësisë së të Urtëve, që vullnetarisht dhe me marrëveshje zgjidhen nga të dyja palët. Kjo bëhet sepse e kërkon Kanuni kur ka grindje: jo e imja, jo e jotja – ndërmjet personave të fisit. Kur larja e fajeve i lihet në dorë për zbatim gjykimit privat, ahëre del në pah prishja e popullsisë dhe dobësia e qeverisë.

Kushdo e sheh qartë se krimi dëmton po aq personin privat sa edhe e shrrëgullon shoqërinë sepse ia dhunon ligjet, kështuqë, në qoftë se shteti, për interesin e veçantë të të cilit është fjala nuk ndërhyr në gjykim, arbitrarri është i pavlefshëm. Kështu përpiluesit e studimit duan të paraqesin origjinën e këtij abuzimi në Shqipëri me qëllim që të shmangin pasionin dhe interesat njerëzore me të cilët ngjyrosot dhe shtrembërohet e vërteta.

Shqipëria Venedike (trojet etnike shqiptare të administruara nga Venediku) është një vend në kufirin bregdetar me Sulltanin. Në të dyja këto hapësira popujt nuk kanë një gjykatës të përbashkët, prandaj për arsye të qetësisë është i nevojshëm arbitrazhi, sepse mungon autoriteti për një ligjshmëri të pakundërshtueshme. Kjo gjë në të vërtetë nuk është aspak kundër arsyes, por nga ana tjetër, fakti që krimet e shtetasve të mos i nënshtrohen gjykimit të gjykatës është drejtpërdrejt në kundërshtim me arsyen e shtetit dhe me natyrën e nënshtetësisë. Kështu, përpiluesit e studimit justifikojnë ekzistencën e një grupi të veçantë për të kryer gjykime në formën e institucionit të arbitrazhit. Në bashkësinë e komuniteteve njerëzore padyshim që janë institucione zyrtare venedikase, por siç ka



ndodhur në Rizon të Kotorrit, që u pajis me titullin e bashkësisë me Kapedan dhe Zëvendës dhe Gjykatës, për shkak të traditës vendase doli se banorët e Rizonit në rrugë të veçantë dhe unike ia dolën të merrnin në dorë jo vetëm gjykatën civile por edhe atë penale. Kështu, institucionet juridike venedikase u formalizuan. Autoriteti gjyqësor venedikas nuk funksionon. Çfarë duhej bërë?

U vendos një kompromis, të krijohej një institucion hibrid, ai i arbitrazhit, por me lejen e zyrtarëve shtetërorë venedikas. Shqiptarët e kuptuan fuqinë e këtij parimi të ndërmjetëm. Kështu u krijua një realitet i ri gjyqësor që nga forma ishte venedikase, por nga përmbajtja ishte tipik kanunor dhe shqiptar. Ahëre u përcaktuan dhe rregullat përkatëse të funksionimit të arbitrazhit.

Kështu, në bashkësinë e vendeve që nuk kanë pjesë në grindje zgjidhen 12 veta prej fajtorit (që ka bërë fajin ose krimin) dhe ata dërgohen te shtëpia e atyre që kanë pësuar fyerje, për të kërkuar prej tyre pezullimin e inateve, pezullim që quhet premtim apo besë. Këta 12 të dërguar paraqesin disa dhurata të vogla si fjongo, gjilpëra, shami, për të treguar dëshirën që ka fajtori për një pajtim të singertë dhe të qëndrueshëm. Dy herë ata kthehen mbrapsh pa e marrë fjalën e besës, hera e tretë është vendimtare. Nëse pranohen herën e tretë ndërmjetësit është simboli që të fyerit janë gati për kompromis.

Ata kthehen te shtëpia e fajtorit, i cili për të bërë provën e fundit të seriozitetit merr 12 djepe dhe ia dërgon të fyerit së bashku me ndërmjetësit, të 12 djepet janë të mbuluara me mahrama, mbulesa me qëndisje të dendur që përdoren nga shqiptarët, dhe në secilin djep është vendosur një monedhë e quajtur real prej floriri. Kur hiqen mahramat nga djepet shihen edhe monedhat. Kur ndërmjetësit arrijnë te porta e të fyerit, u bëhet pyetja se cilët janë. Ata duke iu shmangur përgjigjes që do të mund të ringjallte kujtimin e fyerjes, i

përgjigjen: "Hape derën kumbarë, që të pranosh Zotin dhe Shën Gjonin." Kështu, pasi porta nuk hapet as të parën dhe as të dytën herë, ia nisin për herë të tretë: "Hape derën kumbarë, që të pranosh Zotin dhe Shën Gjonin, mos na kthe mbrapa, për fatin tënd, për fëmijët e tu, për mbarësinë e punëve të tua, për rritjen e konakut tënd".

Si hapet porta e shtëpisë dhe pranohen dhuratat, nis e shtrohet biseda për caktimin e besës dhe caktohet afati brenda të cilit, sa të rregulloren punët e nevojshme për gjykimin duhet të mos pësojnë dëm njerëzit e njëres palë dhe tjetres dhe numërohet si turpi më i madh sikur besa të thuhej dhe të zezohet me mashtrim.

Numri i gjykatësve rregullohet sipas rëndësisë së krimit: nëse është fjala për vdekje duhet të ketë 24 vetë, për plagosje 12 vetë. Për vjedhjet, grabitjet dhe mashtrimet 6 ose 4 vetë. Për shpifjet veprohet me kumbari dhe vëllamëri.

Kështu, dëmshpërblimi jepet me coha në ngjyrë të kuqe ose me mbulesa të qëndisura mahrame ose paguhet me realë. Shpifja dëmshpërblehet në këtë mënyrë vetëm kur nuk ka cenuar nderin dhe jetën, sepse fyerjet e tjera, zënkat e përditshme nuk merren fare parasysht. Për plagosje, dëmshpërblimi ka vlerë 10 realë ose 10 zenikë. Kësaj i shtohet dhe shuma që ka shpenzuar i plagosuri për kirurgjinë. Jeta e një burri vlerësohet e barabartë me 12 gjaqe ose me 12 zekinë të plotë. Gruaja e vranë çmohet vetëm me gjysmën e kësaj shume. Nëse vrasja ka ndodhur gjatë kohës së besës, ahëre vrasësi gjykohet pavarësisht nga e drejta e tij e mëparshme.

Zyrtarë venedikas mbas dhënies së dënimit nga arbitrazhi i shkruajnë vendimet gjyqësore. Mëqenëse shqiptarët nuk kanë vullë për ta bërë autentik dhe të vlefshëm dokumentin, bëjnë dy kopje në të cilat ngjisin një grosh raguzian dhe e ndajnë në mes. Ata e çmojnë kaq shumë të nevojshëm këtë ngjitje, sa që e quajnë të pavlefshëm vendimin gjyqësor nëse ky do të ishte pa

këtë kërkesë.

Si të lexohet vendimi, gjykatësit ngrihen në këmbë dhe qëndrojnë ndërmjet dy palëve, të cilët vihen rresht dhe ahëre paraqitet vrasësi duke mbajtur të varur në qafë armën me të cilën ka vranë, dhe duke ecur në gjunjë zvarritet tek përfaqësuesi i familjes së të vranit për t'i kërkuar falje. I dëmtuari ia heq armën që ka vrasësi dhe e përqafton atë pasi e ka lënë t'i lutet tri herë.

Po kështu veprojnë të dy palët, pastaj përqaftohen dhe kuptohet se vendimi është pranuar. Përpiluesit anonimë të studimit për Kanunin shprehin habi se si vallë një popull i varfër si shqiptarët mundet të veprojnë me një urtësi të tillë.


Por në fund të studimit ata nuk ngurrojnë të shtojnë se ky arbitrazh është i papranueshëm për normat juridike zyrtare venedikase dhe është "një abuzim i së drejtës sovrane në ushtrimin gjyqësor".

Pra, ligjet zyrtare të Venedikut janë ato që bëjnë një kompromis me ligjet shqiptare të Kanunit. E gjithë kjo histori marramendëse është e para katër shekujve.

Si vallë para katër shekujve shteti i Venedikut nuk qëndron indiferent për shtetasit shqiptarë? Shqipëria sot ka një kod juridik tepër të përparuar dhe bashkëkohor, të standardeve ndërkombëtare.

Kanuni i Veriut është në aktivitet ende. Normat parashtetërore nuk i përfillin ligjet shtetërore. Venedikasit shpikën institucionin e arbitrazhit, të organizuar nga shqiptarët, por me lejen e tyre. Kjo tregonte interes dhe vëmendje të venedikasve. Natyrisht që sot është marrëzi të operosh me kompromise të normave parashtetërore dhe ligjeve shtetërore.

Unë jam për plotfuqishmërinë juridike të shtetit dhe jo të Kanunit. Por nuk mund të kuptoj dot indiferencën e shtetit shqiptar. Shembulli i shtetit venedikas më vë në mendime. Venedikasit përpiluan dhe një studim të posaçëm për Kanunin Shqiptar. Po shtetarët shqiptarë çfarë bëjnë, heshtin, futin kokën në dhe' si struçet. /KultPlus.com



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Bashkimi debuton me fitore të madhe në FIBA Europe Cup

PRIZREN, 25 SHTATOR - Bashkimi i Prizrenit ka shënuar fitore të madhe në debutimin evropian. Të mërkurën mbrëma në palestrën "Sezai Surroi", që

ishte e mbushur me shikues, Bashkimi e mposhti gjigantin polak të basketbollit, Anwil Wloclawek. Prizrenasit ishin vazhdimisht në epërsi, ndërsa në fund

fituan me shifrat 80:75. Anwili është prej skuadrave më të mëdha në FIBA Europe Cup. E ka fituar këtë garë në vitin 2023. Dhe ndeshja mes Bashkimit dhe

Anëilit ishte e para e raundit kualifikues të FIBA Europe Cup. Ndeshja e kthimit zhvillohet në Wloclawek të Polonisë më 1 tetor.



NGA I PADËSHIRUARI TE HERO I DINAMO ZAGREBIT, MEDIUMI I MADH KROAT E NGRIT NË QIELL ARBËR HOXHËN

ZAGREB, 25 SHTATOR - Dinamo ka hapur fazën e grupeve të Ligës së Evropës me një fitore 3-1 në Maksimir kundër Fenerbahçes. Blutë kaluan në epërsi me një gol të Dion Belja në minutën e 21-të, ndërsa Sebastian Szymanski ka barazuar pesë minuta më vonë. Belja ia ka dhënë Dinamos përsëri epërsinë në minutën e 50, me asist nga Arber Hoxha, ndërsa golin e tretë e shënoi Monsef Bakrar në minutën e 93-të. Hoxha, së bashku me

golashënuesin e dyfishtë Belja, është bërë protagonist i fitores së madhe evropiane të klubit të Zagrebit. Jo vetëm për shkak të asistimeve, por edhe për ndikimin e përgjithshëm në lojë. Tanimë mediumi më i madh kroat "Index.hr" ka shkruar një shkrim të gjatë duke lavdëruar paraqitjen e Arbër Hoxhës dhe formën e shkëlqyer që po kalon ish-sulmuesi i Prishtinës, Ballkanit dhe Slaven Belupos. "Arbër Hoxha ka qenë

vendimtar në dy sfidat e fundit të Dinamo Zagreb, duke i siguruar dy fitore të mëdha, në kampionat ndaj rivalit të madh Hajduk Split ku shënoi gol dhe tani ndaj Fenerbahçes me një asistim. Sulmuesi 26-vjeçar, i cili në prag të sezonit ishte konsideruar tepër i kufizuar në formacionin sulmues të Mario Kovacevic, pati shansin e tij në 11-shën e parë kundër Hajdukut në Poljud të shtunën e kaluar", ka shkruar mediumi kroat.



RRËFEHET ROONEY: KAM PASUR PROBLEME TË MËDHA ME ALKOOLIN, PA GRUAN TIME DO TË ISHA I VDEKUR



LONDËR, 25 SHTATOR - Wayne Rooney, legjendë e futbollit anglez dhe golashënuesi më i mirë në histori të Manchester Unitedit, ka zbuluar në podcastin me ish-bashkëlojtarin e tij, Rio Ferdinand, se e kishte kaluar një periudhë të shënuar me probleme serioze me alkoolin. Ish-sulmuesi anglez ka folur pa filtra të një "momenti mjaft të

vështirë si person", i cili rrezikonte t'ia shkatërronte krejt karrierën si futbollist. "Natyrishë që e kam ekzagjeruar, kisha ardhur në një pikë që të mos kthehesha më. Mendoja se nuk mund të kërkoja ndihmë nga askush, në realitet nuk doja ta bëja, sepse nuk doja që t'i ngarkoja të tjerët me një peshë të tillë", ka thënë Rooney. Ish-futbollisti i Evertonit dhe

Manchester Unitedit e kujton, po ashtu, periudhën kur ishte munduar ta fshihte gjendjen e tij nga trajnerët dhe nga shokët e skuadrës. "Mbaj mend kur shkoja në stërvitje me pika në sy dhe me çamçakëz. Ndonjëherë pija për dy ditë rresht", ka treguar ish-përfaqësuesi anglez. Paradoksalisht, pikërisht në ato vite ishte duke i kaluar

momentet e tij më brilante në fushë me gola vendimtarë dhe paraqitje që e kishin shndërruar në ikonë të Manchester Unitedit dhe të kombëtares angleze. Vendimtare dhe shpëtimtare në atë periudhë ishte gruaja e tij, Coleen. "Sinjerisht, mendoj se nëse ajo nuk do të ishte përkrah meje, sot do të isha i vdekur", ka përfunduar Rooney.

GENOA INTERESOHET PËR ERNEST MUÇIN



TRABZONSPOR, 25 SHTATOR - Ernest Muçi ka gjasa të mëdha që sezonin e ardhshëm të paraqitet në Serinë A të Italisë. Është bërë me dije se është skuadra e Genoas që ka shprehur interesim për mesfushorin e Kombëtares së Shqipërisë. 23-vjeçari

është huazuar te Trabzonspori nga Beshiktashi, ekip me të cilin ka kontratë deri në verën e vitit 2027. Muçi ka marrë kritika për paraqitjet e tij te Tranzonspori dhe, sipas të gjitha gjasave, kjo skuadër nuk do ta shfrytëzojë opsionin e blerjes së tij.

Te Genoa po e shohin Muçin si përforcim të duhur për sulmin dhe pritet që vitin e ardhshëm të bëjnë ofertë zyrtare për kartonin e tij. Para Beshiktashit, Muçi ka luajtur edhe në Poloni te Legia e Varshavës, kurse me Shqipërinë ka 16 paraqitje dhe tri gola të shënuar.

Rashica fiton besimin e trajnerit Sergen Yalcin

BESIKTAS, 25 SHTATOR - Sulmuesi i Kosovës, Milot Rashica, është kryefjala e medieve turke para derbit Galatasaray - Besiktas. Ai është kthyer me asistim dhe fitore te skuadra e

Beshiktashit pas rikuperimit nga lëndimi. Rashica ishte i pazëvendësueshëm në fitoren 4:0 te Beshiktashit në duelin e mbetur në udhëtim te Kayserispori. Madje Rashica ka asistuar në golin e

katërt të shënuar nga Beshiktashi në fillim të pjesës së dytë për ta konfirmuar paraqitjen e tij të mirë. Për Rashicën ky ishte asistimi i dytë këtë sezon në 6 paraqitje në të gjitha garat, ndërsa i

pari në kampionat. Është bërë me dije se kjo paraqitje e Rashicës ka bindur trajnerin Sergen Yalcin që ta projektojë 29-vjeçarin startues edhe në duelin e radhës kundër Kocaelisporit.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Ro-Bin Stone”shpk, Klinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Impantin e Përpunimit, Thërrmimit dhe Seperimit të Gurit Gëlqeror, në Dresnik, Klinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.11.2025 në ora 10:00 në Objektin e SHFMU “Zgjimi Gremnik”, në fshatin Gremnik, Klinë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Ro-Bin Stone” shpk, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Ro-Bin Stone”shpk, Klinë, për Pëlqim Mjedisor, – për Impantin e Përpunimit, Thërrmimit dhe Seperimit të Gurit Gëlqeror, në Dresnik, Klinë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Art Minerals” L.L.C. Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Shfrytëzimin dhe Seperimin e Rërës Kuarcore, në Z.K. Pjetërshan, Gjakovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.11.2025 në ora 11:00 në Objektin e SHFMU “Anton Çetta”, Dol, Gjakovë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Art Minerals” L.L.C. Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkdVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Art Minerals” L.L.C. Gjakovë, për Pëlqim Mjedisor, – për Shfrytëzimin dhe Seperimin e Rërës Kuarcore, në Z.K. Pjetërshan, Gjakovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania N.T.SH “Mishtore Extra -1” Bellacërkë, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit dhe konservimit të mishit N.T.SH “Mishtore Extra -1” Bellacërkë, Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 12.11.2025 në ora 10:00 në Objektin e SHFMU "Liria", fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, do të organizohet debat publik nga Kompania N.T.SH “Mishtore Extra -1” Bellacërkë, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/5792017802?pwd=zYko53aWI93a7xPD4PdVGG2Sj5q2Au.1&omn=81301481471>

Meeting ID: 579 201 7802

Passcode: z6a21c

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë N.T.SH “Mishtore Extra -1” Bellacërkë, Rahovec, për Pëlqim Mjedisor, – për Fabrikën e përpunimit dhe konservimit të mishit N.T.SH “Mishtore Extra -1” Bellacërkë, Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arlind Vehapi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m.e. “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigi Gurakuqi” Nashec.
- Luan Lleshi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.
- Arben Dylazeka shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.
- Saranda Ibishi, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë Ekonomike “Hasan Prishtina”.

- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.
- Endrit Rudhani, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë Ekonomike “Hasan Prishtina”.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Florent Haxhimehmeti shpall të pavlefshme dëftesën e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme të gjimnazit “Frang Bardhi”.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Kaltrina Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat QK “11 Marsi” Prizren.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Halim Buduri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IV shfmu “ Nazim Buduri “ Hoqa e Qytetit.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Adem Shabanaj shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën e testit maturës, diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

PROCUREMENT NOTICE

Procurement of Works for Rehabilitation of the Sewerage and Stormwater Networks

Deadline 10.11.2025

Republic of Kosovo

Project Ref-No: BMZ No. 2018 67 209, 2020 67 924, 2022 67 037; KfW Procurement No. 513015

Ref.: Climate Appropriate Urban Development - Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II)

Procurement of Works for Rehabilitation of the Sewerage and Stormwater Networks

Recipient: Regional Water Company Prishtina J.S.C. (RWC Prishtina)

Funding: KfW Development Bank

Project measures:

The Regional Water Company Prishtina J.S.C. has received financing from KfW Development Bank toward the cost of the “Climate Appropriate Urban Development - Sewage Prishtina (incl. Sewage I/II)“, and intends to apply part of the proceeds toward payments under the contract for “Procurement of Works for Rehabilitation of the Sewerage and Stormwater Networks”.

Requested services:

The project involves within core urban area of two cities and one village the rehabilitation and new construction of approximately 14 km of sewage pipes using open trench methods. The pipes will range in diameter from DN300 to DN1500, with corrugated polypropylene (PP) and glass-reinforced plastic (GRP) as the chosen materials. Additionally, around 3 km of existing pipes (ranging from DN350 to DN1200) are scheduled for rehabilitation through inlining technology. Further, the scope of work includes the construction of approximately 4 km of stormwater pipes (ranging from DN300 to DN1200) using open trench construction methods. Furthermore, approximately 900 m of existing stormwater pipes (DN800 and DN1500) will be rehabilitated using the inlining technique. The project will also involve the construction of ten combined sewer overflows, complete with mechanical and electrical equipment, and the execution of 14 trenchless crossings beneath main roads and railway lines (DN300 to DN1500).

The contract may include optional works of a similar scope.

The Contract will be ruled by the Banks Harmonized Edition of the Conditions of Contract for Construction prepared and copyrighted by the International Federation of Consulting Engineers (FIDIC), edition 2010.

The Time for Completion of the Works is 1095 calendar days, followed by the Defects Notification Period of 365 calendar days.

Bidding will be conducted by means of the International Competitive Bidding procedure with qualification as specified in the KfW Guidelines for Guidelines for Procurement of Goods, Works and associated Services in Financial Cooperation with Partner Countries (“KfW Guidelines”).

A complete set of tender documents will be provided in softcopy version via a download link upon submission of a written request (during working hours, 08:00–16:00, Monday to Friday, excluding official holidays) at the address given below. Each application must clearly state the company name, contact person and all relevant contact details.

Name of Contact Person:

Mr. Faton Ramadani,
Acting Head of PIU / Project Manager

Address:

Str. Hazir Shala no.4,
10000 Prishtina,
Republic of Kosovo

Email address:

wastewaterprogram@kru-prishtina.com

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Besartë Kelmendi B.I.“MS Muslimah Style” me seli në Klinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812211259 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da Besartë Kelmendi B.I.“MS Muslimah Style” Klin donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812211259 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that Besartë Kelmendi B.I.“MS Muslimah Style” based in Klina, has come to the decision to quit its business: 812211259 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

